



**Republika e Kosovës – Republika Kosova**  
**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia**  
**Izborni Panel za Žalbe i Predstavke**

**A nr. 167/2013**

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Muhamet Rexha kryesues, Xhevdet Abazi dhe Ferit Osmani anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), dega në Lipjan paraqitur kundër subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), dega në Lipjan, për shkak të vendosjes së flamujve në objekte publike, për Zgjedhjet Lokale, në seancën e panelit të mbajtur me 09.10.2013, mori këtë:

### **VENDIM**

**Refuzohet** si e pabazuar ankesa e subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK)

### **Arsyetim**

Me datën 06.10.2013, subjekti politik LDK, ka parashtruar ankesë në PZAP, në të cilën ankesë pretendon se, me datë 06 Tetor 2013 subjekti politik PDK në Lipjan ka vendosur flamujt e subjektit politik në oborrin e shkollës fillore “Vëllezërit Frashëri” në Lipjan, me të cilin veprim sipas parashtruesit të ankesës është bërë shkelje ligjore e nenit 4.1 pika b), të Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike.

Në cilësinë e provës, parashtruesi i ankesës ka bashkangjitur dy fotografi si dëshmi.

PZAP-i, në kuptim të nenit 4 paragrafi 3 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, e informoi subjektin politik PDK, me datën 06.10.2013, për ankesën që është bërë ndaj këtij subjekti politik dhe ka kërkuar që të përgjigjet ndaj ankesës deri më datë 07.10.2013 deri në ora 16:00. Sipas afatit të caktuar PZAP-i pranoi përgjigjen e kërkuar nga subjekti politik PDK, lidhur me ankesën Anr 167/2013, të paraqitur nga subjekti politik LDK, ku theksohet se pretendimet e parashtruesit të ankesës janë të pabazuara, të paargumentuara, të supozuara dhe të njëanshme. Po ashtu në përgjigje të ankesës theksohet se fotot e ofruara si dëshmi nuk janë dëshmi të mjaftueshme dhe nuk mund të konsiderohen si prova të mjaftueshme, dhe se pretenduesi përveç fotove nuk ka sjell asnjë provë tjetër për të dëshmuar kohën e kryerjes së veprimeve jo ligjore, dëshmitarët eventual dhe identifikimin e personave që kanë mundur ti kryejnë këto veprime. Andaj me këtë rast subjekti politik PDK kërkon nga PZAP-i që këtë ankesa ta hudhë si të pabazë.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj ankesën gjeti se:

### **Ankesa është e pabazuar**

Pretendimet e parashtruesit të ankesës se anëtarët e subjektit politik të PDK-së, kanë vendosur flamujt e këtij subjektit në oborrin e shkollës fillore “Vëllezërit Frashëri” në Lipjan, nuk qëndrojnë ngase dëshmitë e ofruar nga parashtruesi i ankesës nuk janë dëshmi të mjaftueshme me të cilën vihet në dyshim se është kryer një veprim i ndaluar, për arsye se nga fotografit e ofruar si provë nga subjekti politik i LDK nuk identifikohet qartë se për çfarë objekti bëhet fjalë dhe se mbi këtë bazë një pretendim i tillë i ankesës konstatohet nga PZAP si i pabazë dhe i pa argumentuara në prova dhe në dëshmi bindëse për shkeljen e pretenduar, prandaj duke u bazuar në nenin 118 paragrafi 1 të LZP-së, dhe në kuptim të nenit 115.1, lidhur me ankesën e lart përmendur u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

### **Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia**

A nr. 167/2013 më datën 09.10.2013.

**Kryesuesi i Panelit  
Muhamet Rexha**



#### ***Udhëzim Juridik:***

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i, në rast se gjoba e përfshirë është më e lartë sesa pesëmijë (5, 000) Euro ose në rast se çështja prek një të drejtë themelore.*